



Planuar / Dateduar Punëgjend / Produced Received / Delivered	24.03.2022	viti god year	2
Organ / Njësia Org / Unit	Nr Prot Pr Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
BKDYSHHC	1573/2022		114



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr.174/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetare, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë dhe Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, duke vepruar sipas Aktgjykimit me numër A.nr.1315/19, të datës 18.02.2022, të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.214/2019 të datës 22.03.2019, të parashtruar nga ankuesja [redacted] me adresë banimi [redacted] Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit/Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në çështjen juridike "masë disiplinore" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 24.03.2022, mori këtë:

**V E N D I M**

**PËRFUNDON** procedimi administrativ i iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.214/2019 të datës 22.03.2019, e parashtruar nga ankuesja [redacted]

**A r s y e t i m**

Ankuesja [redacted] sipas shkresave të lëndës është e punësuar në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, sipas ndryshim plotësimit të akt emërimit me numër të datës 11.07.2018 në pozitën "Udhëheqëse e Divizionit për Menaxhimin e Resurseve Ujore".

Ndaj ankueses [redacted] Sekretari i Përgjithshëm i kësaj ministrie njëherit edhe Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i ankueses për këtë periudhë, përmes e-mailit zyrtar, me datë 28.12.2018 i ka shqiptuar vërejtje me shkrim, e cila vërejtje ka ardhur si rezultat i mungesës në punë të ankueses për datën 27.12.2018, me ç'rast e njëjta ka qenë si zëvendësuese e Drejtorit dhe për këtë datë është dashur të jap përgjigje lidhur me një kërkesë nga Ministri dhe të përcillet për në kabinetin e Kryeministrit.

Ankuesja kundër vërejtjes me shkrim të datës 28.12.2018, me datë 28.01.2019 ,ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor me datë 22.02.2019, ka nxjerrë vendimin me numër protokollit Nr.KZKA-4/2019, me të cilin e ka refuzuar ankesën e ankueses te datës 28.01.2019 me numër prot.426/19.

Ankuesja e pakënaqur me vendimin Nr.KZKA-4/2019 të datës 22.02.2019, të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, me datë 22.03.2019, parashtron ankesën me numër të protokollit 1537/2019, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me pretendimet ankimore se vendimi Nr.KZKA-4/2019 i datës 22.02.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor është nxjerrë si rezultat i shkeljeve thelbësore procedurale, shkeljes se ligjit material dhe vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 25.03.2019, ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankueses, tek Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, ndërsa me datë 29.03.2019, Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor me shkresat e bashkangjitura për lëndën e ankueses.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri me datën 08.10.2020, ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankueses, ndërsa me datën 13.05.2019, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka njoftuar ankuesen për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës dhe e ka udhëzuar se mund të ndjek procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesja ka ndjekur procedurat e tjera, duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative me datën 18.02.2022 ka nxjerr Aktgjykimin me numër A.nr.1315/19, i njëjti në Këshill është pranuar me datë 28.08.2022 sipas të cilit ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses dhe ka anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 13.05.2019, duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e datës 22.03.2019.

Me datën 22.03.2022, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përmes e-mailit zyrtar, ka pranuar njoftimin nga Udhëheqësja e Divizionit për Burime Njerëzore në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor se ndaj ankueses masa disiplinore "vërejtje me shkrim" e datës 28.12.2018, është shlyer dhe është hequr nga dosja personale,



ku e njëjta me datën 26.01.2022 e ka njoftuar edhe ankuesen lidhur me këtë çështje pas interesimit të saj drejtuar përmes e-mailit zyrtar të datës 26.01.2022.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën e ankueses me numër protokollit 1537/2019 të datës 22.03.2019; E-mailin zyrtar të datës 09.05.2019 nga ankuesja për KPMSHCK-në; E-mailat zyrtar të ankueses të datës 22.03.2019; Përgjigjen e datës 13.05.2019 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Dëshminë mbi përcjelljen e vendimit të KZKA-së e datës 22.02.2019 për ankuesen; Vendimin me numër Nr.KZKA-4/2019 të datës 22.02.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Vërejtjen me shkrim të datës 28.12.2018; Ankesën e ankueses të datës 28.01.2019 për Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; E-mailat zyrtar të datës 28.12.2018 të ankueses; E-mailin zyrtar të datës 28.12.2018; E-mailin zyrtar të datës 04.01.2019; E-mailin zyrtar të datës 27.12.2018; Shkresën zyrtare të datës 31.12.2018 të ankueses; Bisedat në viber të ankueses si dëshmi e ankueses; Raportin mjekësor të datës 26.12.2018; Vërtetimin mjekësor të datës 12.02.2019; E-mailin zyrtar të datës 03.01.2019; E-mailin zyrtar të datës 28.12.2018; E-mailin zyrtar të datës 27.12.2018; Bisedat në viber të ankueses si dëshmi e ankueses për datën 27.12.2018; E-mailin zyrtar të datës 14.05.2019; E-mailin zyrtar të datës 24.12.2018; E-mailin zyrtar të datës 14.05.2019; E-maili zyrtar i datës 07.05.2019; E-maili zyrtar i datës 22.03.2019; Kërkesën për përgjigje në ankese të datës 25.03.2019; Përgjigjen në ankese të datës 29.03.2019 me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Ndryshimin dhe plotësimin e akt emërimit të ankueses të datës 11.07.2017; Gjendjen për hyrje-daljet për periudhën prej 26.12.2018-28.12.2018 për ankuesen; Kërkesën për pushim të ankueses të datës 27.12.2018; Dosjen e pushimit (vjetor, mjekësor, përdëllimit dhe prindëror) për ankuesen për vitin 2018; Dëshminë nga MMPH lidhur me dërgimin e vendimit të KZKA-se për ankueses sipas listës së regjistrimit; Padinë e datës 03.06.2019 e parashtruar nga ankuesja për Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Aktvendimin e datës 22.10.2021 nga Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative lidhur me përgjigjen në padi të Këshillit; Përgjigjen në padi të datës 16.11.2021 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Aktgjykimin me numër A.nr.1315/2019 të datës 18.02.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; E-mailin zyrtar të datës 22.03.2022 si dhe E-mailat zyrtar të datës 26.01.2022.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara si nga ankuesja ashtu edhe nga organi i punësimit, ka konstatuar se objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën e ankueses është bërë i pamundur, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se Udhëheqësja e Divizionit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, përmes e-mailit zyrtar me datë 22.03.2022, ka njoftuar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës se vërejtja me shkrim e datës 28.12.2018 e shqiptuar ndaj ankueses është larguar nga dosja personale. Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në bazë të kësaj rrethane konstaton se objekti i shqyrtimit të ankueses se ankueses është bërë i pamundur ose i kotë, pasi që e vërejtja me shkrim e shqiptuar ndaj




ankueses bazuar në paragrafin 3 të nenit 7 të Rregullores Nr.04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil, ka pasur afatshmërinë e shlyerjes brenda një (1) viti nga dita e dhënies së tyre, e krejt kjo në pajtim edhe me nenin 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: **“Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë”**, andaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka vendosur për përfundim të procedimit administrativ në pajtim me nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**  
**Lënda me numër A.nr.174/2022**

Ardita Peraku Shyti  
  
Procesmbajtëse



**Vendimi i dërgohet**

- Ankueses
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

